

URDHËR
Nr. 370, datë 3.4.2026

**PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR. 609, DATË 19.6.2025, “PËR
DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES LISË SË DHENVE DHE TË DHIVE,
TË SHFAQUR NË SHTETIN E RUMANISË”**

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës, në pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 609, datë 19.6.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes lisë së dhenve dhe të dhive, të shfaqur në shtetin e Rumanisë”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri